

VENDIM
Nr. 804, datë 29.12.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1069, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE “TRUALL”, NGA
PRONË SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, PËR SHOQËRINË “BLOJA” SHPK,
TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS (KOMUNA
E PARISIT – RRUGA
E KAVAJËS)””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, dhe 8, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr. 1069, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:
“1. Tjetërsimin e pasurisë shtet, me sipërfaqe 703 (shtatëqind e tre) m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 3866, me numër pasurie 521/1, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama